

# PUSHIMI MJEKËSOR ME PAGESË: ÇFARË DUHET TË DINË PUNËDHËNËSIT

Disa punëdhënës janë të obliguar ta zbatojnë Earned Sick Time Act (Paid Sick Leave Law) (Aktin për Kohën e Fituar të Pushimit Mjekësor në bashkinë e New York-ut (Ligjin mbi pagesën e pushimit mjekësor), duke filluar nga data 1 Prill, 2014. Sipas ligjit, punëtorët e siguruar kanë të drejtën ta shfrytëzojnë pushimin mjekësor për tu trajtuar dhe për tu kujdesur për vetveten apo për ndonjë anëtar të familjes së tyre.

Department of Consumer Affairs (DCA) (Departamenti për Qështje të Konsumatorëve) ka përgatitur këtë fletushkë për t'i informuar punëdhënësit në lidhje me përgjegjësitë që kanë sipas ligjit. DCA do t'i rifreskojë të dhënat sipas nevojës. Ju lutemi keni vëmendjen në datën që është shënuar në fund të kësaj fletushke. Për të lexuar ligjin dhe Pyetjet më të Shpeshta në lidhje me ligjin, shko ne faqen [nyc.gov/PaidSickLeave](http://nyc.gov/PaidSickLeave).

## PUNËDHËNËSIT QË KANË PËR DETYRË TË JAPIN PUSHIM MJEKËSOR

Numri i Punëtorëve	Kohëzgjatja e Pushimit Mjekësor për një Vit Kalendarik	Pushim Mjekësor i Paguar apo i Papaguar	Vlera e Pagesës
5 ose më shumë <i>Duhet të punoj 80+ orë për një vit kalendarik*</i>	Deri në 40 orë	I Paguar	Vlera e rregullt e pagesës, por jo më pak se \$8 për një orë (paga minimale)
1-4 <i>Duhet të punoj 80+ orë për një vit kalendarik*</i>	Deri në 40 orë	I Papaguar	Nuk aplikohet
1 ose më shumë punëtorë të brendshëm <i>Duhet të punoj 80+ orë për një vit kalendarik dhe duhet të jetë i punësuar nga i njejt punëdhënës së paku për 1 vit</i>	2 ditë	I Paguar	Vlera e rregullt e pagesës, por jo më pak se \$8 për një orë (paga minimale)

\*Shënim: "Viti Kalendarik" nënkupton çdo periudhë kohore e rregullt dhe vijuese në kohëzgjatje prej 12-muajve e caktuar nga punëdhënësi.

**Shënim:** Nëse jeni pjesë e programit dhe rregullave ku lejohet shfrytëzimi i pushimit mjekësor, atëherë rregullorja juaj duhet ti përmbush kushtet dhe të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara me ligj.

## PUNËDHËNËSIT PUNËTORËT E TË CILËVE NUK JANË TË MBULUAR ME PROCEDURAT LIGJORE

Ligji nuk ju ofron mbulesë punëtorëve të cilët punojnë 80 orë, ose më pak, gjatë një viti kalendarik; studentëve në programet federale të studimeve; punëtorëve puna e të cilëve kompenzohet nga programet e kualifikuara për bursë; punëtorëve të agjencioneve qeveritare; terapistëve fizik; terapistëve profesional; patalogjistëve gjuhësor të të folurit; otologjistëve të cilët janë të licensuar nga Departamenti i Edukimit të Shtetit të New York-ut nëse caktojnë shërbime në mënyrë vullnetare, nëse e caktojnë vetë orarin e tyre të punës, të cilët kanë mundësinë ta refuzojnë ose pranojnë shërbimin që iu referohet atyre, dhe të cilët paguhen me një pagë mesatare për një orë, e cila është së paku 4 herë sa minimumi i pagës federale; kontraktorët e pavarur të cilët nuk i përkasin definicionit ose nuk i përmbushin kushtet të jenë punëtorë nën [New York State Labor Law](http://New York State Labor Law) (Ligjin e Punës të Shtetit të New York-ut); pjesëmarrësit në Programet e Eksperiencës së Punës; dhe disa punëtorë të cilët janë pjesë të marrëveshjes së ujdive kolektive. Në rastet e marrëveshjeve të ujdive kolektive, punëtorët nuk janë të mbuluar me këtë ligj nëse marrëveshja përjashton në mënyrë ekspresive provizionet e ligjit dhe nëse ofrohen benefite të krahasueshme. Megjithatë, për punëtorët në industrinë e ushqimit dhe në industrinë ndërtimore, të cilët janë të mbuluar me marrëveshjen e ujdive kolektive, ligji nuk aplikohet nëse marrëveshja përjashton në mënyrë ekspresive provizionet e ligjit. Për informata në lidhje me marrëveshjet e ujdive kolektive, lexo Pyetjet e Shpeshta në faqen [nyc.gov/PaidSickLeave](http://nyc.gov/PaidSickLeave).

## NJOFTIM PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Punëtori	Data e Shënuar e Njoftimit për Punëtorin
Punëtor i ri <i>I punësuar fillimisht me datë ose pas datës 1 Prill, 2014</i>	Dita e parë e punësimit
Punëtor ekzistues <i>Tashmë duke punuar për punëdhënësin para datës 1 Prill, 2014</i>	1 Maj, 2014

Ju jeni të obliguar ta pajisni çdo punëtorë me një njoftim me shkrim në lidhje me të drejtat e tyre për pushimin mjekësor, duke përfshirë ditët e akumuluar dhe ato të harxhuara të pushimit mjekësor, të drejtën për të paraqitur ankesë në rast nevoje, dhe të drejtën për të qenë i/e lirë nga kompenzimi ose shpagimi. Në njoftim duhet të figuroj viti kalendarik, duke përfshirë Data e Fillimit dhe Data e Mbarimit. Punëtorët kanë të drejtën për një njoftim të tillë të shkruar në gjuhën angleze, dhe, nëse është e disponueshme në webfaqen e DCA, edhe në gjuhën e tyre amtare. Njoftimi mund të gjendet në faqen [nyc.gov/PaidSickLeave](http://nyc.gov/PaidSickLeave).

## DITËT E AKUMULUARA DHE ATO TË HARXHUARA TË PUSHIMIT MJEKËSOR – DATA TË RËNDËSISHME

	Norma e kohës së grumbulluar	Data e fillimit	Data kur mund ta përdorni Pushimin Mjekësor
<b>Punëtori</b>	1 orë për çdo 30 orë të punuara	<b>1 Prill, 2014</b> ( <i>Punëtori ekzistues</i> )	<b>30 Korrik, 2014</b> ( <i>Punëtori ekzistues</i> )
		<b>Dita e parë e punës</b> ( <i>Punëtor i ri</i> )	<b>120 ditë pas ditës së parë të punësimit</b> ( <i>Punëtor i ri</i> )
<b>Punëtor Vendorë</b>	2 ditë pas 1 viti në punë	DCA ju pajis me informata në faqen <a href="http://nyc.gov/PaidSickLeave">nyc.gov/PaidSickLeave</a>	DCA ju pajis me informata në faqen <a href="http://nyc.gov/PaidSickLeave">nyc.gov/PaidSickLeave</a>

*Përfshim:* Nëse ndonjë punëtor është i mbuluar me marrëveshjen e ujdive kolektive që do të ishte në fuqi në datën 1 Prill, 2014, atëherë punëtori fillon ti grumbullojë ditët e pushimit mjekësor sipas ligjit të Qytetit duke filluar nga data kur të mbaron marrëveshja e lartpërmendur.

## MBAJTJA E TË DHËNAVE

Ju duhet ti mbani dhe ti ruani të gjitha të dhënat që do të dokumentonin përpunueshmërinë me ligjin, për së paku tri vite. Çdo informatë në lidhje me shëndetin e punëtorit duhet ta mbani sekret dhe konfidencial dhe nuk guxon të bëhet publike, përpos në raste kur punëtori u lejon juve një gjë të tillë, ose nëse të dhënat e tilla kërkojnë nga ligji. Poashtu, ju jeni të detyruar që ti bëni të disponueshme të dhënat tek DCA nëse kërkojnë përmes ndonjë kërkesë në ndonjë datë të caktuar.

## NJOFTIM PARAPRAK

Nëse parashikohet ndonjë nevojë e arsyeshme, atëherë ju mund të kerkoni nga punëtori që të aplikoj për pushim mjekësor paraprakisht, me saktë 7 ditë para datës së fillimit të pushimit mjekësor. Por nëse paraqitet nevoja në mënyrë të pa parashikueshme, atëherë ju mund të kerkoni nga punëtori që të aplikoj për pushim mjekësor sa më shpejt që (është e arsyeshme).

## VËRTETIMI

Ju mund të kerkoni vërtetim nga shërbyesi i licensuar mjekësor nëse ndonjë punëtor përdorë pushim mjekësor më shumë se tri ditë pune të njëpasnjëshme. Paid Sick Leave Law (Ligji mbi Pushimin Mjekësor me Pagesë) ju ndalon që të kerkoni nga shërbyesi mjekësor arsyen e pushimit mjekësor; e keni të ndaluar ta pyetni për qëllimin dhe gjendjen specifike shëndetësore të punëtorit. Sidoqoftë, informata të tilla mund të kërkojnë në raste tjera të përcaktuara me ligj.

## PUSHIMI MJEKËSOR I PAPËRDORUR

Punëtori mund ti bartë deri në 40 orë të pushimit mjekësor në vitin pasues kalendarik. Sidoqoftë, ju jeni të obliguar ti lejoni një punëtori ti shfrytëzojë më së shumti deri në 40 orë pushim mjekësor brenda një viti kalendarik. Ju mund të zgjidhni—por nuk jeni të obliguar—që ta paguani punëtorin për orët e pashfrytëzuara të pushimit mjekësor në fund të viti kalendarik. Punëtorët nuk mund ti bartin orët a papërdorura nëse ju vetëm ia keni kompenzuar me para, DHE nëse ju e keni pajisur punëtorin me sasinë e orëve të pushimit mjekësor në përputhje me kërkesat ligjore për vitin e ri kalendarik, në ditën e parë të vitit kalendarik.

## KOMPENZIMI

Ju nuk mund të kerkoni kompenzim nga punëtorët kundrejt kërkesës për pushim mjekësor. Kompenzim ose shpagim përfshihet çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje të pozitës, suspendim, apo reduktim të orarit të punës, apo çdo akt tjetër në dëm të punëtorit i/e cila tenton apo shfrytëzon të drejtën e tij/saj të garantuar me ligj.

## ANKESAT

Nëse ndonjë punëtor paraqet ankesë tek DCA, DCA do t'ju kontaktoj juve me anë të email-it për një përgjigje me shkrim. Ju jeni të obliguar të përgjigjeni brenda afatit prej 30 ditëve. DCA do të bashkëpunoj me juve dhe me punëtorin për ta shqyrtuar dhe zgjidhur ankesën. Ne poashtu do ju asistojmë juve që të arrijmë tek një marrëveshje.

## NJOFTIM PËR KUNDËRVAJTJE

Nëse pranoni ndonjë vërejtje për kundërvajtje, ju do të keni mundësinë ta zgjidhni dhe ta shlyeni kundërvajtjen pa pasur nevojë për një seancë gjyqësore, apo edhe mund të paraqiteni para gjykatësit të paanshëm tek Tribunali i DCA.

*Shënim:* Të gjithë punëdhënësit janë të obliguar ti binden këtij ligji duke filluar nga data 1 Prill, 2014. Deri në datën 1 Tetor 2014, punëdhënësit e shënuar më poshtë do të kenë mundësinë që të vërtetojnë dhe sigurojnë qasjen e tyre bazuar në ligj pa u ndëshkuar, dhe një shkelle e bërë para datës 1 Tetor 2014, nuk do të numërohet si kundërvajtje për punëdhënësit si më poshtë:

- Punëdhënësit me 1 deri në 19 punëtorë
- Bizneset Prodhuese të listuara në sektorët 31, 32, dhe 33 të U.S. Department of Labor's North American Industry Classification System (Sistemit të Klasifikimit të Industrisë Amerikane të Departamentit të Punës në Amerikën Veriore (NAICS). Për listën e plotë shko tek faqja [http://www.bls.gov/oes/current/naics2\\_31-33.htm](http://www.bls.gov/oes/current/naics2_31-33.htm).

## Pyetje? A dëshironi ta ndiqni një trajnim për të mësuar më shumë për ligjin?

Thirr në numrin 311 (212-NEW-YORK jashtë NYC) dhe kërko informata për Pushimin Mjekësor me Pagesë.